



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 482 Prot.

Tiranë, më datë 12.08.2025

VENDIM

Nr. 444, datë 12.08.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Sqj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 12.08.2025:

VENDOSI

1. Miratimin e Raportit të Verifikimit në terren “Të gjetjeve arkeologjike rastësore të identifikuar nga Znj. Brisida Gjikondi, në afërsi të fshatit Kolanec, Bashkia Maliq”, hartuar nga Drejtoria e Shërbimit Arkeologjik në IKTK në bashkëpunim me DRTK Korçë;
 2. Të realizohet nga DSHA në bashkëpunim me DRTK, Korçë dhe Departamentin e Arkeologjisë në FHF, gërmimi i tumës së identifikuar në afërsi të fshatit Kolanec, Bashkia Maliq;
 3. Rezultati i gërmimit arkeologjik dhe dokumentimi i gjetjeve të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje në KKTKM;
 4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
 5. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
 6. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Joli MITROJORGJI

